



KOMUNA SUHAREK
SUHAREK MUNICIPALITY
OPŠTINA SUHAREK

30-09-2024

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRË NË DORËZIM-PRIMLJENO-RECEIVED			
Njësia org. Org. Jedinica Org. Untt	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	05256893	Z	

Raporti I punës së kryetarit për periudhen Janar Shtator 2024

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Në bazë të urdhëresës së Kryetarit mbi raportin e punës 9 (nëntë) mujor, nga data **03.01.2024-27.09.2024**, ku gjatë periudhës 9 (nëntë) mujore kemi punuar si më poshtë:

- **Sektori i Shërbimeve publike**

Gjatë 9 (nëntë) muajve të vitit 2024, në Sektorin e Shërbime Publike janë kryer punë të ndryshme që kanë të bëjnë me natyrën e punës së kësaj Drejtorie. Disa nga punët më të rëndësishme në këtë drejtori ishin:

- Si zakonisht në çdo ditë punë bashkëpunimi dhe koordinimi me stafin e Drejtorisë për punët brenda ditës javës, muajit, dhe 9 (nëntë) muajve të këtij viti, për kërkesat e ndryshme si dhe nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente.

- Brenda këtyre nëntë muajve me bashkëpunëtorë të Drejtorisë, kemi bërë edhe vizita në teren për kërkesa të ndryshme, si dhe shqyrtimi i tyre në teren, siç është fjala për (strehim, kanalizim, ujësjellës dhe infrastrukturë), por gjithmonë sipas kërkesave të qytetarëve, si dhe me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve, Publike, dhe Emergjencë, dhe në fund kemi bërë raport me shkrim, dhe ku i kemi raportuar Drejtorit të DSHPE.

- Po ashtu takime të shpeshta me Drejtorin dhe bashkëpunëtorët e drejtorisë, si dhe me Menaxherët e projekteve për rregullimin dhe riparimin e ndriqimit Publik në komunën tonë.

- Përgaditja e raportit me shkrim për çdo muaj për kryerjen e pagesës, së konsulentit individual për efikasitet të energjisë.

- Kërkesat për zotime për çdo javë, muaj, 6 (gjashtë) dhe brenda 9 (nëntë) muajve, për pagesa të ndryshme brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, si për investime kapitale, mallra dhe shërbime, për shpenzime komunale, si dhe pagesa të ndryshme brenda Drejtorisë.

- Përgaditja e performancës për ujësjellëse dhe kanalizime për vitin **2023** në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë, si dhe përgaditja për çdo vit me vendim të Kryetarit të Komunës.

- Inicimi si zakonisht i Procedurave për mallta dhe shërbime për vitin 2024, nga muaji Janar deri në muajin nëntor, si dhe inicime të ndryshme brenda Drejtorisë.

- Inicimi si zakonisht i Procedurave të projekteve kapitale për vitin 2024, rrugë, kanalizime, trotuare, si dhe inicime të ndryshme brenda Drejtorisë.

- Pranimi i faturave të shpenzimeve komunale dhe mallrave dhe shërbimeve, si dhe kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat shpenzimeve komunale të Rrymës, Ujit, Telefonit, Mbeturive.

- Po ashtu kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat të ndryshme për mallra dhe shërbime brenda sektorit të Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë.

- Kryerja e pagesave për punëtorët e zjarrfikësive dhe faturave të ndryshme për këtë sektor. - Inicimi i procedurave minimale me zyrën e Prokurimit, për nevojat e zjarrfikësive në kuadër të DSHPE.

- Shpenzimi i Buxhetit me afatet e caktuara nga ZKF-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë tonë, si dhe shumë kërkesa tjera pranë Drejtorisë.

- Kontakte të shpeshta telefonike me Keds-in, Hidroregjionin, Ekoregjionin, PTK-në etj, për nevojat e Drejtorisë-Komunës, të qytetarëve për zgjidhjen e kërkesave të tyre për mes telefonit.

- Caktimi nëpër komisione të ndryshme për nevojat e Drejtorive dhe të Komunës.

- Përgaditja e kërkesave të KEDS-it, si dhe qytetarëve për pëlqimet konkrete të tyre.

- Dhënja dhe pëlqimi i kërkesave për KEDS-in, si dhe bashkëpunime të shumta me ta.

- Lëshimi i dokumenteve për persona fizikë dhe institucione tjera.

- Përgaditja edhe menaxhimi i Planit të rrezikut të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë, sipas kërkesës së Drejtorit dhe Kryetarit të Komunës.

- Përgaditja e planifikimit të buxhetit për çdo vit për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, sipas kërkesës së Zyrtarit Kryesor financiar etj.

- Raportimi i raporteve mujore për qdo muaj për faturat e paguara dhe të papaguara, për mallra dhe Shërbime, për shpenzime Komunale, si dhe investime kapitale në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, duke i raportuar për çdo muaj, zyrtarit Kryesor Financiar të Drejtorisë për ekonomi dhe Financa.

- Kërkesa të shpeshta për ndryshime të faturave nga operatorët e ndryshëm, në bazë të kërkesës të cilën e bëjmë ne si Drejtori e Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë.

- Takime - konsultime të shpeshta me qytetar, për kërkesat dhe nevojat e tyre .

- Takime të shpeshta me stafin për qështje dhe punë të ndryshme brenda drejtorisë, po ashtu takime të shpeshta sipas kërkesës së Drejtorit në zyrën e tij për punët e Drejtorisë.

- Bashkëpunim të ndërsjellë me të gjitha sektorët e Drejtorive e në veqanti me Drejtorinë e Urbanizmit, Zyrën e Prokurimit, Drejtorinë e Arsimit (DKA), Drejtorinë e Administratës, e tjera) ,pastaj me “Hidro-regjionin Jugor” njësia Suharekë “ Eko-regjionin “ njësia Suharekë , KEDS-in , dhe PTK-në etj.

1.

1. Deri me tash kanë ardhur në drejtorinë 221 kërkesa të ndryshme (100%),

- 93 kërkesa janë miratuar apo 42.08%,
- 97 janë refuzuar apo 43.89%
- 14 janë deleguar me aktpercjellsa ne drejtori te ndryshme 6.33 %
- 5 janë Hedhur posht apo 2.26 %
- 2 janë anuluar 0.90%
- 10 sosh janë në proces apo 4.54%.

2. Mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit.

Vërejtje: Më posht po i paraqes mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit për vitin Qershor2023-Shtator 24

Pastrimi i rrugëve lokale, 247572 m’

Mirëmbajtja dhe pastrimi i shesheve, parqeve, shtigjeve te ecjes dhe lapidarëve, 151350 m2

Pastrimi dhe mirëmbajtja e /hedhurinave ne varreza, 258333 m2

Mirëmbajtja e gjelbrimit ne parqe, sheshe, shtigje te ecjes dhe pergjate brezit rrugor, 311870 m2

Mirëmbajtja dhe pastrimi i hapsirave publike (te perbashketa) ne objektet shumebanesore 384 cope

Ujitja e hapsirave publike ne Komunë, 23760 m2,

Largimi I mbeturinave shtazore, 265 copë.

Largimi dhe transporti i mbeturinave me vëllim 405.34 ton

Mirëmbajtja dhe pastrimi i shtratit te lumit në Suharekë, 3500m’

3. Në kuadër të projektit, Ngritja e kapaciteteve njerzore drejt nje shoqerie te shendosh faza e dytë, e kemi pasur takimin me perfaqesuesit e JICA-s, shkollat fillore kan vazhduar me aktivitetin e tyre ne kuader te PP1. Ne kemi mbajtur ligjerat me 17 Shkolla, ku 12 kanë qenë prezenc në kuzin final. I kemi ndarë 3 çmime për shkollat fituese.
4. Në kuadër të projektit “ Mirëmbajtja dhe pastrimi i deponive” kemi filluar për pastrimin e deponive ilegale në Komunë. Kemi vazhduar ne hospitim e tyre dhe jemi dakorduar qe pas festes te fillohet me eliminim e tyre. kemi vazhduar ne deponit ne Nishor), Breshanc, Reshtan, Grejqevc, Biraq. Është bërë pastrimin e deponive ilegale në Komunë. Kemi filluar me eliminimin e deponive për gjatë rrugës Suahrekë-Carralevë si dhe ne deponin ne Duhel. Peqan , Sllapuzhan , Semetisht, Breshanc, Bllacë, Semetisht, Nishor, Në Maqitevë, si dhe në zonen industriale, Stravuqinë afer ujit, pergjate rruges per budakoveë, si dhe mohlan dhe pjeset tjera si dhe në Bllacë dhe mbi fshat.
5. Në kuadër të projektit Mirëmbajta e rrugëve lokale nga Bora, Operatori në fjalë ka mbajtur kujdestari, deri me tani nuk ka pasur nevoj per intervenime. Rruget janë të pastruar dhe të kalueshme për qarkullim. Ku vlera perfundimater e sherbimeve ka qenë 110,613.00 Eur.

- Sektori për infrastrukturë

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2024, sipas procedurave ligjore janë përgatitur dokumentacionet për Projektet Kapitale për vitin fiskal 2024. Janë bërë fillimisht sistematizimi i dokumentacionit të vitit paraprak të projekteve, pergatitje të dokumentacioneve, zotimi i mjeteve si dhe hartimi i projekteve për projektet kapitale të vitit fiskal 2024 si dhe kërkesa dhe Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondevepër inicim të procedurave, si dhe hartimi i projekteve për projektet kapitale të vitit fiskal 2024 për këto projekte:

- 1) Ndërtimi i rrugëve lokale: Aziz Limoni - segment, Sejdi Fejza-segment, Izet Shefketi, Milazim Balaj dhe "Bajram Islami" etj. në Doberdelan (e perfunduar)
- 2) Ndërtimi i rrugëve lokale: Tahir Zeqiraj, Ragip Haziraj, Ibrahim Rugova - segment, Zeq Avdyli, Lugjet e verdha - degzim- Maksutaj. në Gjinoc (ne fazen perfundimtare)
- 3) Ndërtimi i Trotuarit në rrugë"Murat Kadriaj" në Krushicë e Epërme
- 4) Ndërtimi i Trotuarit në rrugën "Sylejman Delvina " në Krushicë e Poshtme
- 5) Ndërtimi i rrugëve lokale: "Jakup Salihu"," Halil Bajselmani"etj. në Maqitevë (e perfunduar)
- 6) Ndërtimi i rrugëve lokale: Isa Shala, Haxhi Zyberi, Muhamet Qamili etj. në Nepërbisht (e perfunduar)
- 7) Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Pentagoni" në Papaz
- 8) Ndërtimi i rrugëve lokale: Miftar Bytyqi, Shefket Bytyqi,etj. në Kasterc (e perfunduar)
- 9) Ndërtimi dhe rregullimi i varrezve në "Biraq"etj .
- 10) Ndërtimi i rrugëve lokale: Kosova - vazhdim, Shqiptari - vazhdim, Eqerem Qabej - segmente, Besnik Perzhaku - segmente. Në Studenqan (e perfunduar)
- 11) Ndërtimi i rrugëve lokale: Rruga tek varrezat - vazhdim etj. në Sllapuzhan (e perfunduar)
- 12) Ndërtimi i rrugëve lokale: Dyrrahu, Udha e Shkronjave etj. në Savrovë
- 13) Ndërtimi i urave në Komunë, Grejkoc, Tërrnje, Sllapuzhan etj. (e perfunduar)
- 14) Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve lokale në Komunë

- 15) Ndërtimi i nënstacionit policor(mini stacion)dhe mini objektit për zjarrfiksa (ne fazen e perfundimit)
- 16) Ndërtimi i rrugëve lokale: Bullaket - vazhdim, Nur Ramadani - segment, Demajt dhe "Ramiz Ajeti-segment etj. në Nishor (ne fazen perfundimit)
- 17) Ndërtimi i rrugëve lokale Vazhdim i rruges Seferi, Dy martiret, Veterani etj në Greiqec
- 18) Vazhdimi i rrugës së vazrrezave në Baqevc
- 19) Ndërtimi i mullirit të vjetër në Breshance
- 20) Ndërtimi i rrugëve lokale Mehmet Xhafa Nebih Kokollari, Bjeshka e Budakoves etj. në Budakovë
- 21) Ndërtimi i rrugëve lokale Rame Hyseni, Bexhet Baraliu, Tip Zyba, Naser Baraliu, Halil Ali Fetahu, Hajir Sopa etj. në Bukosh
- 22) Ndërtimi i rrugëve lokale Malokajt-segment, vazhdim i rruges Faik Maliqaj, vazhdim i rruges adem Rrustemi etj në Dubravë
- 23) Ndërtimi i rrugëve lokale Vëllezerit Qatani, Tajar Hatipi etj në Duhël
- 24) Ndërtimi i rrugëve lokale Hafir Gashi në Javor
- 25) Ndërtimi i rrugëve lokale Bashkim Kabashi-segment, Atdhetari etj. në Leshan
- 26) Ndërtimi i rrugëve lokale Qamil Gashi, Aneks i rruges Fadil Gashi, Trotuari etj në Mohlan
- 27) Ndërtimi i rrugëve lokale Minatori, Ali V Bytyqi, Xhemali, Haki Sokoli, Haxhi Abazi Taf Sherifi dhe rruga Djelli –aneks në Mushtisht (ne fazen perfundimtare)
- 28) Ndërtimi i rrugëve lokale Mursel fandaj , amerika dhe rruga te shkolla etj në Peqan
- 29) Ndërtimi i rrugëve lokale Ramush Matoshi dhe Sadri Buzhala etj. në Popolan
- 30) Ndërtimi i rrugëve lokale vazhdim i rrugës ne lagjen Tafolli në Qadrak
- 31) Ndërtimi i rrugës Rozafa-vazhdim
- 32) Ndërtimi i rrugëve lokale flamuri i Arbrit, mulliri-segment
- 33) Ndërtimi i rrugëve lokale Martim Camaj, Deli Azem Gega-segment
- 34) Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve ne Komune
- 35) Ndërtimi i rrugëve lokale UCK, Sinan Alija, Uke Nrecaj etj.
- 36) Ndërtimi i rrugëve lokale Haxhi V.Bytyqi, Spitali i Luftes-segment në Semetisht
- 37) Ndërtimi i rrugëve lokale Rruga Stravuqinë-Muhlan
- 38) Ndërtimi i rrugëve lokale Fetah Gega-segment, Asllan Gesha, Elshanet, drini segment etj. në Shirokë
- 39) Ndërtii i rrugëve lokale nga rruga Vardari deri te rruga Jakup Ferri në Tërrnje
- 40) Ndërtimi i rrugëve lokale Dyrrahu, Udha e Shkronjave etj në Vraniq
- 41) Ndërtimi i zonave te gjelbruara dhe rekreative ne Mushtisht, Samadrezhe dhe Suharekë
- 42) Ndërtimi i urave në Komune, Tërrnje, Sllapuzhan

- 43) Ndërtimi i rrugës Samadrexhe-Terrnje-Studençan etj.
- 44) Ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza në Dubrave
- 45) Ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza në Sllapuzhan

- PROJEKTET E FINANCUARA NGA MAPL DHE DEMOS ME BASHKËFINANCIM (GRANTI I PËRFORMANCËS)

- 1) Nderimi i fushave sportive-Qendra Rekreative Sportive ne lagjen Fidanishte-Suharekë
- 2) Ndertimi i tregut javor dhe hapsirave te gjelbërta ne Shirokë
- 3) Ndertimi i rruges KOSOVA ne Studençan
- 4) Ndertimi i rruges "Deshmoret Bytyqi" ne fshatin Sopi
- 5) Ndertimi i parqeve me kende te lojrave ne Duhël,Bllacë,Vraniq dhe Mushtisht

-Marrëveshje e mirëkuptimit për bashkëfinancimin e PROJEKTIT: RENOVIMI I "URËS SË TRANZITIT" DHE RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT "TOPHULLA" në mes MZHR dhe Komunës së Suharekës.

Po ashtu në kuadër të Programit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë “Rruga drejt përdorimit efikas të burimeve natyrore vendase” e financuar në kuadër të programit Ndërkufitar IPA II të Bashkimit Evropian Shqipëri-Kosovë, ku investimi është bërë në “Instalimi i ndriqimit Led me elemente përcjellëse në fshatin Gelancë”

- Sektori i parandalimit të zjarrit

Gjatë këtij nëntë mujori kemi kryer punët e parapara në planin vjetor të punës duke filluar prej inspektimeve të objekteve për rrezikshmëri nga zjarri, dhënjën e pëlqimeve në dokumentacionim investivo-teknik për masat e mbrojtjes nga zjarri, si dhe daljes në vendin e ngjarjes me rastin e zjarreve, të cilat kanë qenë të shumta për shkak të temperaturave të larta.

Palëve të dëmtuara si pasoje e zjarreve, në disa raste shtëpi banimi, ju kemi lëshuar vërtetime mbi dëshminë e rastit të ndodhur, dhe dëmet e shkaktuara nga zjarri.

Më poshtë do të eidentoj punët të cilat janë kryer në periudhën kohore Janar-Qershor 2024 duke u bazuar në Planin vjetor të punës.

1. Inspektime të rregullta.....	20
2. Inspektime fillestare.....	5
3. Në sektorin Publik.....	3
4. Në sektorin privat.....	22
5. Inspektime kontrolluese.....	20
6. Masa të shqiptuara.....	130
7. Pëlqime.....	15
8. Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....	12
9. Goditje rrufeje.....	2

- Sektori i njësisë së zjarrëfikësave

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera

për periudhën kohore Janar - Shtator 2024 -
Komuna e Suharekës

Realizimi i numrit të përgjithshëm të interven, struktura e zjarreve dhe int.tjera Janar-Shtator 2024													
2023	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejs h	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
Janar	17	13	2	0	2	0	0	0	1	1	0	0	0
Shkurt	51	48	0	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	13	11	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	15	13	0	1	1	0	0	0	1	1	0	2	2
Maj	12	3	3	2	3	0	1	0	7	7	0	0	0
Qershor	27	15	2	6	3	1	0	0	9	9	0	0	0
Korrik	81	68	5	4	4	0	0	0	3	3	0	0	0
Gusht	109	106	2	0	1	0	0	0	3	3	0	1	1
Shtator	40	37	0	2	1	0	0	0	4	4	0	0	0
Gjithsejtë	365	314	14	18	17	1	1	0	28	28	0	3	3

Drejtoria për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari gjatë këtyre 9 muajve ka realizuar aktivitete dhe punë të shumta të ndara sipas sektoreve të Drejtorisë.

Nga Janari viti 2024 Sektori i Pylltarisë i cili ka qenë sektor brenda Drejtorisë së Bujqësisë ka kaluar në kaudër dhe përgjegjësisë së Agjencionit të Pyjeve të Kosovës. Poashtu edhe stafi që ka qenë kuadër të Drejtorisë ka kaluar në Agjencion të Pyjeve.

Kemi inicuar të gjitha procedurat tenderuese për projektet kapitale që janë të planifikuara në buxhet të realizohen për vitin 2024.

Projekte kapitale që janë realizuar gjatë këtyre 9 muajve janë;

1. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore për Bujqësi dhe Pylltari ka përfunduar.
2. Ndërtimi i Serave për fermerë, ka përfunduar konstruksioni për të gjitha serat, aktualisht është duke u vendos najlloni, ku shumë shpejt pritet të përfundoj projekti.
3. Asfaltimi i rrugës në bjeshkë të Vraniqit, kanë përfunduar të gjitha punimet.
4. Ndërtimi i sistemit të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore në Komunë. Punimet janë realizuar në fshatin Samadraxhë.

NDËRTIMI I SISTEMIT TË UJITJES SË SIPËRFAQEVE BUJQËSORE

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural këtë vit do ta financoj projektin për Ndërtimin e sistemit të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore në Komunën e Suharekës, në vlerë prej rreth 300,000.00 €. Në si Dejtori kemi dorëzuar projektin kryesor në Ministri dhe është realizuar marrveshja e Memorandum Bashkpunimit në mes Komunës së Suharekës dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Sipas marrveshjes Komuna e Suharekës inicon procedurën tederuese dhe se aktualisht ky projekt është në fazën e tenderimit. Projekti do të rrelizohet në tre lokacione në fshatrat Vraniq, Studenqan dhe Mushtisht. Sipas projektit do reliaizohen rreth 6000 metra.

Ndërtimi i Serave

Tek ky projekt kemi përfunduar thirrjen për aplikim ku kanë aplikuar mbi 300 fermerë.

Projekt ka filluar të zbatohet në terenëm ku janë rreth 99 fermerë përfitues me sipërfaqe të përgjithshme rreth 1.5 ha me sera.

Sirat janë të tri llojeve: 500m², 200m² si dhe 100 m².

Ky projekt pritet të përfundoj në fillim të muajit tetor.

TRAJTIMI I QENEVE ENDACAK

Trajtimi i qeneve endacak është në kuadër të përgjegjësisë së Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, ku këtë vit kemi zhvilluar procedurat e prokurimit dhe kemi nënshkru kontratën për trajtimin e qeneve endacak sipas procedurave dhe ligjeve në fuqi.

Janë trajtuar 262 qenë.

SUBVENCIONIMI I QUMSHTIT

Në kuadër të projektetve të realizuar me Subvencione si Drejtori për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, jemi duke e bërë subvencionimin e qumshtit me 0.03 cent për fermerët blegoral.

Në këtë 6 mujor, kemi hapur thirrjen për aplikim për subvencionim të qumshtit për 6 mujorin e 2-të të vitit 2023, ku kanë aplikuar gjithsej 63 fermerë dhe të gjithë nga këta kanë plotësuar kriteret dhe kanë përfituar nga ky subvencionim i Drejtorisë për BZHRP.

Subvencionim i qumshtit ka vazhduar edhe për vitin 2024, ku kemi hapur thirrjen publike për aplikim edhe për 6 mujorin e parë të vitit 2024, ku kanë përfituar 67 përfitues me vlerë të përgjithshme prej 24,420.27 euro.

SUBVENCIONIMI I SIPERFAQEVE ME ARRA

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2024, ka paraparë të mbështes sektorin e pemtarisë - kulturen e arrës dhe lajthisë përmes subvencionimit me 300 € për ha.

Ka përfunduar faza e aplikimit për fermerë sipas Thirrjes Publike, ku kanë përfituar rreth 70 fermerë.

SUBVENCIONET – Pagesat Direkte të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari ka përfunduar me sukses fazën e fazën e aplikimit për Pagesa Direkte – Subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Numri i fermereve aplikues ka arritur në 1237.

Si Drejtori në mënyrë që asnjë fermerë të mos mbetet pa aplikuar, kemi punuar edhe pas orarit të rregullt si dhe vikendeve

Poashtusi pjesë e thirrjes së programit të pagesave direkte Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar edhe pjesën tjetër të programit, ku fermerët kanë kryer aplikimin e tyre për therjet e raportuar të gjedhit, viqave për majmeri, sasinë e dorëzuar të grurit, subvencionimi i pjesëshem për sasinë plehut artificial.

Kemi pasur vizita në teren në shumicën e fshatrave të Komunës së Suharekës.

Vizitë në teren në: Greiqec, Njëpërbisht, Budakovë, Sallagrazdë, Samadraxhë, Studençan, Peqan, Leshan. Reshtan, Maqitevë, Sllapuzhan, Mohlan, Suharekë, Gjinoc, Krushicë. Greikoc, Savrovë, Doberdelan si dhe shumicën e fshatrave të Suharekës.

Stafi i drejtorisë ka dal në teren ku ka pasur kërkesa për vlersim të dëmeve dhe ka bërë raporte të detajuar varsisht prej dëmeve që ka hasur ne teren.

Gjiashtu kemi pasur takime me organizata të ndryshme edhe vendore edhe ndërkombëtare.

Marrveshje bashkpunimi me Islamic Relief Kosova

Kemi arritur marrveshje bashkfinancimi me Islamic Relief Kosova për subvecionimin e fermereve me mekanizëm bujqësor.

Vlera financiare e marrveshjes 296,956.52€. Numri fermereve përfitues nga kjo marrveshje do të jetë rreth 300 fermerë.

Llojet e mekanizmit bujqësor janë:

1. Freza 1.60 m
2. Freza 1.80m
3. Mbjellse gruri
4. Mbjellse Misri
5. Motokultivatr me frezë dhe kos
6. Motokultivator 4.4 kw
7. Labina 7.5 kw me frezë
8. Automizer

Implementimi i marrveshjes do të bëhet këtë vit.

Marrveshje bashkëpunimi me IADK

Në kuader të bashkëpunimit 3 vjeçar që ka komuna e Suharekës me organizatën Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës për projektin “Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës, projekt tre vjeçar 2023-2025, kemi hapur thirrjen publike për aplikim për fermeret e vegjel për mbështetje të fermereve të vegjel në sektorin e blgtorisë dhe horticultures (pemë dhe perime) me ide dhe aktivitete të përshatshme për digjitalizim dhe ndryshime klimatike.

Mbështetja finaciare:

Vlera minimale e projektit 600 euro.

Vlera maksimale e projektit 1500 euro.

Festari 2024

Ekspozita e produkteve bujqësore:

Në kuader të festës tradicionale të Kultures dhe Veres Festari, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari ka organizuar Ekspozitën e pridhimeve bujqësore, ku fermeret kanë ekspozuar prodhimet e tyre bujqësore dhe blegotorale. Kanë marr pjes rreth 180 fermerë.

Drejtoria për Ekonomi Buxhet dhe Financa

Sektori për Ekonomi, Buxhet dhe Financa;

- Janë faturuar **3039** biznese me vlerë prej: **611,697.25 €**.
- Gjithashtu janë faturuar **144** shfrytëzues të pronës komunale në vlerë prej: **168,642.12 €**.
- Gjatë kësaj periudhe janë aprovuar **193** kërkesa për zbritje të Taksës në Aktivitet ku vlera stornuar është: **86,463.69 €**.
- Gjatë kësaj periudhe kemi dërguar gjithsej **44** vërejtje të fundit për borxhet e akumuluar të shfrytëzuesve të pronave komunale(me vlerë mbi 3,000€).
- Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar **12,093** fletëpagesa për regjistrim të automjeteve ku **326** fletëpagesa janë të liruara ndërsa vlera totale e pagesave është: **128,128.00 €**.
- Janë lëshuar **251** vërtetime dhe **48** çertifikata të ndryshme nga zyrtarët për shërbime të qytetarëve.
- Ne Qendrën e regjistrimit të biznesit deri me datë 25.09.2024 janë regjistruar **203** biznese prej të cilave **73** janë Biznese Individuale, **128** janë SH.P.K., **1** është Shoqëri Aksionare dhe **1** është e huaj me degë në Kosovë
- Në këtë periudhë janë shuar **38** biznese, **3** biznese janë transferuar si dhe janë realizuar **375** modifikime.

Zyra për Regjistrimin e Pasurisë;

- Totali i regjistrimit të pasurisë deri me date **25.09.2024** është **346,459,371.25€** i pasurive kapitale ndërsa i pasurive jo kapitale (vlera nën 1,000.00 €) është **2,951,056.03 €**.

Zyra e Thesarit;

- Nga fillimi i vitit deri më 25.09.2024 janë Çertifikuar dhe Aprovuar **3203** lëndë dhe **12,529,391.29 € pagesa** nga të gjitha programet e Komunës së Suharekës.
- Të gjitha këto pagesa, pas Çertifikimit dhe Aprovimit janë sistemuar në **57 regjistrator** dhe janë arkivuar në Arkivin Financiar të KK në Suharekë.

Sektori i Tatimit në Pronë;

- Janë faturuar dhe dërguar tek tatimpaguesit **9887** fatura të T.PR. me vlerë prej: **885,256.00 €**.
- Të hyrat nga Tatimi në Pronë (objekte dhe toka) deri me 25.09.2024 janë: **442,737.41 €**.
- Janë bërë rreth **1118** inspektime në teren ku gjatë këtyre inspektimeve janë regjistruar **539** objekte të reja, **185** objekte janë paisur me fotografi dhe **184** ndryshime (modifikime) të objekteve. Inspektimet janë realizuar në fshatrat Njëpërbisht, Tërrnje, Gelancë dhe Greikoc.
- Gjithashtu janë lëshuar edhe **312** certifikata për QPS.
- Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar **492** ankesa të tatimpaguesve në të gjithë territorin e Komunës së Suharekës.

Të hyrat vetanake të realizuara deri me datë: 25/09/2024

- Të hyrat nga Tatimi në Pronë:-----**442.737.41 €**
- Të hyrat nga Taksa në Aktivitet:-----**132,688.90 €**
- Të hyrat nga Renta dhe Qeraja:-----**146,943.55 €**
- Të hyrat nga taksa e regjistrimit të automjeteve:-----**128,128.00 €**
- Totali i përgjithshme i realizimit të hyrave vetanake: -----**1,793,776.30 €**
(80% e planifikimit vjetor)

Raporti i shpenzimeve të buxhetit Komunal Janar – 25 Shtator 2024

Emërtimi i Të Hyrave	Buxheti i Alokuar	%	Buxheti i Shpenzuar	%	%
1	2	3	4	5	7=(5:3)
Paga & Shtesa	9,805,379.41		8,973,279.30	91.51%	
Mallra & Shërbime	3,095,596.12		2,013,834.14	65.05%	
Shpenzime Komunale	661,516.32		375,937.08	56.83%	
Subvencione & Transfere	982,596.70		866,571.27	88.21%	
Investime Kapitale	7,844,115.12		4,424,120.21	56.39%	
Totali:	22,389,203.67		16,653,742.00	74.39%	

Drejtoria për Urbanizë Planifikim dhe Mjedisë

Përshkrimi i shkurtër i Aktiviteteve për nëntë mujorin e vitit 2024

Ashtu si në çdo vit edhe në këtë nëntë mujorë të vitit 2024, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedisë ka vazhduar të merret me shqyrtimin e kërkesave për trajtimin e objekteve pa leje, procesi i aplikimit është vazhduar në muajin Nëntor të vitit 2024. Ky proces ka filluar qysh nga korriku i 2019 duke vazhduar kështu në 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024 me një rritje të madhe të kërkesave. Kjo periudhë gjithashtu është karakterizuar me lëshimin e një numri të madh të Çertifikatave mbi legalizimin e objekteve, lëshimin e Dokumentave për Përshkrim Parcele, Pëlqim për Shfrytëzim të Hapësires Publike, Kushte Ndërtimore, Leje Mjedisore dhe Leje Ndërtimore.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedisë në këtë nëntë mujorë ka hartuar draftin e dy dokumenteve - rregulloreve përms grupeve punuese për hartimin e rregullores për bonuset e ndërtimit dhe rregullores për shfrytëzimin e Sheshit (Durrës-Shqipëri 16-17-18 Shkurt 2024)

Poashtu DUPM ka nënshkrua kontratën për hartimin e Planit Rregullues të hollësishëm: Zona Ekonomike Duhël, Plani Rregullues i Zonës Industriale - Shirokë. Pjesë e kësaj do të jetë edhe digjitalizimi i PZHK-së dhe HZK-së, përmes të cilit do t'i mundësohet qytetarit të aplikoj për leje ndërtimore online përmes sistemit E-Leja. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedisë në muajin korrik ka bërë prezantimin publik të dy planeve rregulluese të hollësishme Planin Rregullues i Hollësishëm “Zona Ekonomike” – Duhël dhe Planin Rregullues i hollësishëm “Zona Industriale” – Shirokë.

Nga bizneset dhe qytetarët kemi pranuar propozimet dhe idetë rreth kësaj çështje që të kemi dokumente që i shërbejnë interesit publik.



Përpos punëve të lartëcekura, stafi përgjegjës në DUPM është marrë edhe me kryerjen e punëve tjera varësisht nga lloji i kërkesave të palëve, Komunës dhe Institucioneve jashtë saj.

Në raport janë të përfshirë të gjitha raportet e zyrtarëve të DUPM-së.

Gjatë periudhës kohore 01.01.2024 deri më 30.09.2024 kemi pranuar gjithësejt **357** lëndë të rregullta dhe janë përcjellë **727** shkresa dalëse, ndërsa në Legalizim janë pranuar gjithësejt **77** lëndë kurse janë përcjellë **260** shkresa dalëse. Të bashkangjitur kemi raportin në formë tabelare të lëndeve të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedisë .

Lënde të Rregullta

<i>Lloji i Kërkesës:</i>	<i>Lëndë të Pranuara</i>	<i>Të Aprovuara:</i>	<i>Të Refuzuara</i>	<i>Në Proces</i>
<i>Leje Rrënimi:</i>	<i>13</i>	<i>10</i>	<i>01</i>	<i>02</i>

Kushte Ndërtimore:	62	23	19 (8-Njoftim dhe 2-Terheqje)	10
Leje Ndërtimore:	24	17	02	05
Leje Mjedisore:	23	18	02	03
Përshkrim Parcele:	26	24	(1-Njoftim)	01
Shfrytëzim i Hapësires Publike:	34	22	12	-
Të Tjera:	201 (gjithsej:357)		545-shkresa dalëse (gjithsej: 727)	

Lënde e Legalizimit

Lloji i Kërkesës:	Lëndë të Pranuara	Të Aprovuara:	Të Refuzuara	Në Proces
Çertifikatë Legalizimi:	77	59	/	106 (+vitet e kaluara)
Listë e Pritjes:	-	38		
Plotësim Lënde:		63		
Njoftim për Pagesë:	-	32		
Njoftim për Kadastër:	-	66		
Njoftim për Legalizim:	-	07	260 (Shkresa Dalëse)	

KUSHTET NDËRTIMORE



KOMUNA E SUHAREKË
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA


DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MJEDIS DIRECTORATE
FOR URBANISM, PLANING AND ENVIRONMENT

A: Rr. "Brigada 123" Suharekë 23000,
Republika e Kosovës
029/271-318
045/679-202
urbanizimisuhareke@rks-gov.net
Tel:
E:

KUSHTET NDËRTIMORE 2024

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Aplikuesit	Vëndi	Nr. i referencës së Kërkesës	Lloji i kërkesës	Lloji i ndërtimit	Etazhiteti	Kategoria e ndërtimit	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Nr. i referencës së Zgjidhjes	Mënyra e Zgjidhjes	Zyrtari i lëndës
22	Burim Bytyci	Semetisht	07Nr.350-6907 dt.25.01.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+2	Kategoria I	01163-39	ZK Suharekë	07Nr.106/350-6907 dt.29.02.2024	Kushte Ndërtimore	D.B
23	DSHPE	Suharekë	07Nr.350-7123 dt.26.01.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+1	Kategoria II	02785-6	ZK Suharekë	07Nr.32/350-7139 dt.26.01.2024	Kushte Ndërtimore	E.K
39	"Cima"-Sh.p.K- Bali Kabashi	Suharekë	07Nr.350-8554 dt.02.02.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+7	Kategoria II	2877-0, 584-1, 583-1, 583-3 dhe 582-2	ZK Suharekë	07Nr.68/350-8554 dt.09.02.2024	Kushte Ndërtimore	E.K
62	Nazim Kryeziu	Suharekë	07Nr.350-12121 dt.22.02.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+4	Kategoria II	00389-1	ZK Suharekë	07Nr.154/350-12121 dt.21.03.2024	Kushte Ndërtimore	S.B
65	Nezir Kololli	Suharekë	07Nr.350-12440 dt.23.02.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+2	Kategoria I	00604-9	ZK Suharekë	07Nr.156/350-12440 dt.21.03.2024	Kushte Ndërtimore	D.B
74	Driton Gashi	Suharekë	07Nr.350-12911 dt.27.02.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	PL	Kategoria I	1719-0 dhe 1720-0	ZK Studençan	07Nr.124/350-12911 dt.08.03.2024	Kushte Ndërtimore	V.K
96	"Arsa Construction"- Sh.p.K	Suharekë	07Nr.350-16278 dt.15.02.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+7	Kategoria II	702-1, 702-2 dhe 702-3	ZK Suharekë	07Nr.254/350-16278 dt.30.04.2024	Kushte Ndërtimore	E.K
111	"On Invest"- L.L.C	Suharekë	07Nr.350-18970 dt.29.03.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+4	Kategoria II	1176-15, 1176-16 dhe 1176-20	ZK Suharekë	07Nr.305/350-18970 dt.23.05.2024	Kushte Ndërtimore	E.K
121	"Profil Meta"- Jakup Berisha	Suharekë	07Nr.350-21433 dt.12.04.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+7	Kategoria II	16464-0 dhe 1650-0	ZK Suharekë	07Nr.266/350-21433 dt.07.05.2024	Kushte Ndërtimore	E.K
139	Shaban Krasniqi	Suharekë	07Nr.350-24564 dt.20.04.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+0	Kategoria II	02973-0	ZK Suharekë	07Nr.517/350-24564 dt.30.04.2024	Kushte Ndërtimore	S.B
145	Fazli Beqiraj	Suharekë	07Nr.350-25497 dt.03.05.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+0	Kategoria II	01653-4 dhe 01653-3	ZK Sopijsë	07Nr.277/350-25497 dt.08.05.2024	Kushte Ndërtimore	S.B
156	Shaban Krasniqi	Suharekë	07Nr.350-26842 dt.13.05.2024	Kërkesë	Ndërtim i Ri	P+0	Kategoria II	02973-0	ZK Suharekë	07Nr.517/350-26842 dt.29.07.2024	Kushte Ndërtimore	S.B
190	"Gjini Construction"- Sh.p.K	Suharekë	07Nr.350-31433 dt.06.06.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+1	Kategoria I	369-44, 369-47 dhe 3001-1	ZK Suharekë	07Nr.404/350-31433 dt.25.06.2024	Kushte Ndërtimore	E.K
220	Besim Kuqi dhe Gazmend Kuqi	Suharekë	07Nr.350-34476 dt.25.06.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+1	Kategoria I	00608-3	ZK Suharekë	07Nr.574/350-34476 dt.06.08.2024	Kushte Ndërtimore	D.B
244	"Gjini Construction"- Sh.p.K	Suharekë	07Nr.350-36961 dt.09.07.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+2	Kategoria I	3002-3	ZK Suharekë	07Nr.560/350-36961 dt.02.08.2024	Kushte Ndërtimore	S.B
245	"Gjini Construction"- Sh.p.K	Suharekë	07Nr.350-36960 dt.09.07.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+2	Kategoria I	3002-2	ZK Suharekë	07Nr.559/350-36960 dt.02.08.2024	Kushte Ndërtimore	S.B
261	"Oni 3 Capital"- Sh.P.K-Shkelzen Kavaja	Suharekë	07Nr.350-38625 dt.16.07.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+0	Kategoria I	00603-6	ZK Suharekë	07Nr.475/350-38625 dt.22.07.2024	Kushte Ndërtimore	V.K
286	DSHMS-Besa Kuqi	Suharekë	07Nr.350-41782 dt.31.07.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+2	Kategoria II	857-2	ZK Gjinoc	07Nr.619/350-41782 dt.19.08.2024	Kushte Ndërtimore	B.SH
296	Rasim Reshani	Reqan	07Nr.350-42586 dt.02.08.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+1	Kategoria I	02921-0	ZK Suharekë	07Nr.642/350-42586 dt.27.08.2024	Kushte Ndërtimore	V.N
298	"Gjini Construction"- Sh.p.K	Suharekë	07Nr.350-42696 dt.02.08.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+2	Kategoria II	401-7, 401-8, 401-11 dhe 401-12	ZK Suharekë	07Nr.578/350-42696 dt.07.08.2024	Kushte Ndërtimore	E.K
305	DSHPE (Nënstacioni policor dhe Zjarrfikësat)	Suharekë	07Nr.350-43689 dt.06.08.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+0	Kategoria II	02269-1 dhe 02270-0	ZK Studençan	07Nr.643/350-43689 dt.27.08.2024	Kushte Ndërtimore	A.S
312	Hisni Kadriaj	Suharekë	07Nr.350-45264 dt.12.08.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+2	Kategoria I	01504-58	ZK Suharekë	07Nr.609/350-45264 dt.15.08.2024	Kushte Ndërtimore	D.B
325	Reshat Ndrecaj	Sallagrazhdë	07Nr.350-49923 dt.23.08.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+Nk	Kategoria I	00865-3	ZK Sallagrazhdë	07Nr.652/350-49923 dt.28.08.2024	Kushte Ndërtimore	B.Sh
333	DSHMS-Besa Kuqi	Suharekë	07Nr.350-52520 dt.03.09.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+2	Kategoria II	01528-0	ZK Gjinoc	07Nr.674/350-52520 dt.04.09.2024	Kushte Ndërtimore	B.SH

LEJET NDËRTIMORE

		KOMUNA E SUHAREKËS MUNICIPALITY OF SUHAREKA				DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MJEDIS DIRECTORATE FOR URBANISM, PLANING AND ENVIRONMENT			A: Rr. "Brigada 123" Suharekë 23000, Republika e Kosovës Tel: 029/271-318 Tel: 045/879-202 E: urbanizimisuhareke@rks-gov.net			
LEJET NDËRTIMORE 2024												
Nr.	Emri dhe Mbiemri i Aplikuesit	Vëndi	Nr. i referencës së Kërkesës	Lloji i kërkesës	Lloji i ndërtimit	Etazhiteti	Kategoria e ndërtimit	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Nr. i referencës së Zgjidhjes	Mënyra e Zgjidhjes	Zyrtari i lëndës
55	Bashkim Hoxhaj	Suharekë	07Nr.350-11015 dt.15.02.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+7	Kategoria II	2981-0	ZK Suharekë	07Nr.418/350-11015 dt.27.06.2024	Leje Ndërtimore	E.K
61	"Immo Invest"- Sh.P.K-Edin Berisha	Suharekë	07Nr.350-12001 dt.21.02.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+4	Kategoria II	3000-1 dhe 3000-2	ZK Suharekë	07Nr.327/350-12001 dt.05.06.2024	Leje Ndërtimore	E.K
64	Enver Kastrati	Malishevë	07Nr.350-12381 dt.23.02.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+1	Kategoria II	02979-0	ZK Suharekë	07Nr.187/350-12381 dt.03.04.2024	Leje Ndërtimore	D.B
72	"Gjini Construction"-Sh.p.k	Suharekë	07Nr.350-12865 dt.27.02.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+1	Kategoria I	2821-2, 2821-19, 2933-10 dhe 2933-17	ZK Suharekë	07Nr.192/350-12865 dt.04.04.2024	Leje Ndërtimore	E.K
73	"Gjini Construction"-Sh.p.k	Suharekë	07Nr.350-12868 dt.27.02.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+1	Kategoria I	2933-16 dhe 2821-18	ZK Suharekë	07Nr.193/350-12868 dt.04.04.2024	Leje Ndërtimore	E.K
100	Burim Bytyci	Suharekë	07Nr.350-17128 dt.20.03.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+1	Kategoria I	01163-39	ZK Suharekë	07Nr.295/350-17128 dt.17.05.2024	Leje Ndërtimore	D.B
103	"EH Group"- Sh.P.K	Suharekë	07Nr.350-17389 dt.21.03.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+25+P+7	Kategoria II	02424-1	ZK Suharekë	07Nr.290/350-17389 dt.15.05.2024	Leje Ndërtimore	D.B
113	Nezir Kololli	Suharekë	07Nr.350-20495 dt.05.04.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	PL	Kategoria I	00604-9	ZK Suharekë	07Nr.236/350-20495 dt.24.04.2024	Leje Ndërtimore	D.B
146	"Dielli BL"- Sh.p.k- Bashkim Lumi	Suharekë	07Nr.350-25503 dt.03.05.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+4	Kategoria II	2816-1	ZK Suharekë	07Nr.423/350-25503 dt.28.06.2024	Leje Ndërtimore	E.K
150	Shyhrete Hajredini	Shirokë	07Nr.350-21292 dt.11.04.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+1	Kategoria II	00779-28 dhe 00779-29	ZK Suharekë	07Nr.639/350-21292 dt.26.08.2024	Leje Ndërtimore	E.K
235	"Profil Metal"- Jakup Berisha	Prizren	07Nr.350-36761 dt.08.07.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+7	Kategoria II	3003-1 dhe 3003-2	ZK Suharekë	07Nr.670/350-36761 dt.03.09.2024	Leje Ndërtimore	E.K
264	Fazli Begiraj	Greikoc	07Nr.350-38736 dt.17.07.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+0	Kategoria I	01653-4 dhe 01653-3	ZK Sopijë	07Nr.691/350-38736 dt.10.09.2024	Leje Ndërtimore	S.B
280	DSHPE- Enver Shabani	Suharekë	07Nr.350-40090 dt.24.07.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+1	Kategoria II	02785-6	ZK Suharekë	07Nr.538/350-40098 dt.31.07.2024	Leje Ndërtimore	E.K
285	"ONI 3 Capital"- Sh.P.K- Shkelzen Kavaja	Suharekë	07Nr.350-41778 dt.31.07.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+0	Kategoria I	00603-6	ZK Suharekë	07Nr.556/350-41778 dt.02.08.2024	Leje Ndërtimore	V.K
345	DSHMS-Besa Kuqi	Suharekë	07Nr.350-53806 dt.10.09.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+0	Kategoria II	01528-0	ZK Gjinoc	07Nr.699/350-53806 dt.12.09.2024	Leje Ndërtimore	B.SH
356	Reshat Nrecaj	Sallagrazhdë	07Nr.350-56138 dt.26.09.2024	Leje Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+0	Kategoria I	00865-3	ZK Sallagrazhdë	07Nr.724/350-56138 dt.26.09.2024	Leje Ndërtimore	B.SH

07Nr.722, Datë: 26.09.2024

Raporti i të hyrave Financiare për Muajin Gusht2024

(Leje Ndertimore, Legalizim, Leje rrenimi, Pershkrim parcele, Pelqim ne parim, Pelqim per shfrytezim te hapesires publike, Takse per rregullimin e ifrastruktures, Leje Mjedisore

Komunale)

Gusht 2024						
EminaKuqi	1337	Pëlqim	29.07.2024	31.07.2024	vllesa	455.70
MirlindaKuqi	1339	Pëlqim	31.07.2024	22.08.2024	vllesa	645.20
ShkelzenKavaja	1340	LejeNdërtimore	01.09.2024	01.08.2024	PTK	310.08
Ali Shala	1341	Pëlqim	01.08.2024	01.08.2024	vllesa	460.15

ValonGashi	1342	Pëlqim	09.08.2024	09.08.2024	PTK	50.00
Emir Çeku	1343	PërshkrimParcele	12.08.2024	12.08.2024	PTK	10.00
I-SeferiSh.P.K	1344	Pëlqim	13.08.2024	13.08.2024	vllesa	15.00
ShyhreteHajradini	1345	LejeNdërtimore	15.08.2024	15.08.2024	vllesa	7,026.88
HidroregjioniJugor	1346	Pëlqim	19.08.2024	22.08.2024	ProCredit	3,010.00
FadilBytyçi	1348	PërshkrimParcele	22.08.2024	22.08.2024	PTK	10.00
BajramSopa	1349	PërshkrimParcele	22.08.2024	22.08.2024	vllesa	10.00
KreshnikGalani	1350	Pëlqim	26.08.2024	26.08.2024	PTK	50.00
NaserBinaku	1351	Pëlqim	29.08.2024	29.09.2024	vllesa	420.30
Profil Metal	1352	LejeNdërtimore	30.08.2024	30.08.2024	TeB	51,538.20
						64,011.51
LejeRrënimi						
HisniKadriaj	1347	LejeRrënimi	22.08.2024	22.08.2024	vllesa	161.21
Legalizim						
GëzimBajraktari	21	Legalizim	01.08.2024	02.08.2024	vllesa	461.17
ArbnorBajraktari	22	Legalizim	01.08.2024	02.08.2024	vllesa	35.63
ArbnorBajraktari	23	Legalizim	01.08.2024	02.08.2024	vllesa	431.50
GazmendBajraktari	24	Legalizim	01.08.2024	02.08.2024	vllesa	443.14
IsmetZyba	25	Legalizim	13.08.2024	13.08.2024	vllesa	274.34
ReshatGuraziu	26	Legalizim	14.08.2024	14.08.2024	PTK	1,612.01
						3,257.79
LMK						
Cimashpk	10	LMK	08.07.2024	05.08.2024	PCB	6,057.02

Bashkimiprojekt	12	LMK	23.07.2024			e pa paguar
INK shpk	13	LMK	06.08.2024	06.08.2024	RBK	7,323.24
Cimashpk	14	LMK	07.08.2024			25,691.71
Profil Metal	15	LMK	16.08.2024	16.08.2024	PTK	7,004.39
Arsa Construction	16	LMK	22.08.2024	22.04.2024	RBK	5,675.66
					totali	51,752.02
	LMK	Lejendertimore	Legalizim	Lejerrenimi	totali	119,182.53

TE HYRAT BUXHETORE PER VITIN 2022-2023 -2024 NGA DREJTORIA PER URBANIZEM, PLANIFIKIM dhe MJEDIS – SUHAREKË

NR	MUAJI	VITI 2022	VITI 2023	VITI 2024	
1.	JANAR	130.57 €	40,565.46 €	3,283.02 €	
2.	SHKURT	1.170.83 €	283.14 €	24,083.07 €	
3.	MARS	774.11 €	14,613.38 €	116,352.58 €	
4.	PRILL	11,374.69€	8,460.3€	95,789.68€	
5.	MAJ	7.015.97 €	39,204.06€	121,954.56€	
6.	QERSHOR	61.829.22€	32,261.53€	78.349.76 €	
7.	KORRIK	7.901.53 €	9,296.38 €	97,052.53 €	
8.	GUSHT	4.586,86 €	69,674.72 €	119,182.53€	
9.	SHTATOR	1.287.78 €	71,310.09 €	5.025.81€	
10.	TETOR	29,017.92 €	7,747.50 €		
11.	NËNTOR	20,611.40 €	26,558.68€		
12.	DHJETOR	13,381.09 €	125,379.16€		
	Totali	159,081.97€	437,606.90€		

Tremujori i pare: 2022-2023-2024

1.	2022	2023	2024	2025
	2075.51 €	55,461.98 €	143,718.67 €	

Tremujori i dytë: 2022-2023-2024

1.	2022	2023	2024	2025
	82,295.39 €	135,387.87€	440,491.81 €	

Tremujori i tretë: 2022-2023-2024

1.	2022	2023	2024	2025
	96,071.56 €	285,669.06€	661,073.54 €	

Drejtoria për Administratë

1. HYRJE

Ky raport paraqet punën e Drejtorisë për Administratës në periudhën e Janar- Shtator të vitit 2024. Raporti paraqet aktivitetet dhe punën e Drejtorisë, sipas fushës së përgjegjësisve ligjore, të bazuar në planin vjetor të punës për vitin 2024. Drejtoria e administratës, në kuadër të fushë veprimtarisë së saj ushtron dhe është përgjegjëse për: Ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera Komunale. Bënë ofrimin e shërbimeve administrative, për qytetarët e Komunës së Suharekës, në kuadër të kompetencave vetanake apo të deleguara ligjore të saj. Përgjegjësitë e administratës:

Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera Komunale të Drejtorisë së Administratës përfshijnë: Zbaton dhe bënë regjistrimin dhe mbajtjen e evidencës së materialit zyrtar që pranohet dhe dorëzohet nga zyra e arkivit të administratës së Komunës, si dhe arkivimin e lëndës arkivore dhe kujdesi për ruajtjen e sajë, dhe kujdesi për ruajtjen e akteve materiale të administratës (librat amë, kartotekat, protokollat, regjistrat, etj)

Ofron të gjitha format e shërbimeve dhe të ndihmës juridike për qytetarët, përfshirë regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtresave të tyre dhe bënë raportimin për kryerjen e lëndëve administrative në përputhje

me afatet ligjore.

Është përgjegjëse dhe kujdeset për ofrimin e shërbimeve postare për nevojat e organeve Komunale dhe organeve të administratës Komunale .Ushtron dhe menaxhon me fushën e logjistikës, duke përfshirë menaxhimin dhe kujdesin për automjetet, titullar pronësor i të cilave është Komuna e Suharekës.

Organizon dhe kujdeset për mirëmbajtjen e objekteve të administratës Komunale, duke përfshirë organizimin e shërbimeve të sigurimit për këto objekte.Ushtron të gjitha punët rreth përkujdesjes dhe mirëmbajtjes së teknologjisë informative dhe avancimit të saj për nevoja zyrtare.Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.Për të realizuar detyrat dhe përgjegjësit të cilat burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe kompetencat e deleguara natyrisht kemi mbajtur takime të rregullta me shefa të sektorëve si dhe stafin përgjegjës për ti bashkërenduar punët sipas planifikimit për vitin 2024.Si drejtori kemi paraqitur planin e punës si dhe planin e prokurimit, deri më tani mundë të themi se e kemi realizuar 80% planin e prokurimit, ku kemi zhvilluar procedurat sipas planit.Si drejtori kemi marrë pjesë në të gjitha seancat e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal, dhe sa here është paraqitur kërkesë për raportim dhe sqarime kemi qenë të gatshëm.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Administratës është e organizuar në këta sektorë:

1. Sektori i Gjendjes Civile
